

VENDIM

Nr. 145, datë 26.12.2014

PËRPËRCAKTIMIN E TARIFËS TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OST SHA PËR VITIN 2015

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 59, datë 29.12.2005, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a. për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për vitin 2015 dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve;

VENDOSI:

1. Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për vitin 2015, do të jetë 0.65 lekë/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2015.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti